



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE JURIDIKE DHE ARKIVIT

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

SPECIALIST PER NDJEKJEN E INVESTIMEVE

Ne zbatim te nenit 22 dhe 25 te ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe kreut II, III, IV dhe V, të Vendimit nr.243 date 18.03.2015 te Keshillit te Ministrave "Per pranimin, levizjen paralele, peridhen e proves dhe emerimin ne kategorine ekzekutive", Bashkia Roskovec shpall Procedurat e lëvizjes paralele dhe e pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

Nje vend pune në pozicionin **Specialist per Ndjekjen e Investimeve** në Sektorin e Monitorimit dhe Zbatimit te Kontratave

- Kategoria e pagës IV-3.

Pozicioni i më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në Shërbimin Civil

Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

10/04/2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

15/04/2026

• Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist për Ndjekjen e Investimeve :

Është nëpunës civil në varësi të Përgjegjësit të sektorit. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë:

- Ndjek dhe kontrollon të gjitha punimet që kryhen nga operatorët e ndryshëm që kryejnë aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë për cilësinë, sasinë, afatin të përcaktuar në kontratë,
- Harton shkresat dhe mban korespondencat me të gjithë operatorët ekonomik që realizojnë punimet në bashki, ndërmarrjet vartëse për cilësinë e punimeve.
- Harton preventivët, grafikët e punimeve, afatet e punimeve për investimet që do të realizohen me ndërmarrjen e investimeve, mirëmbajtje dhe dekorit.
- Ndihmon në hartimin e programit vjetor të investimeve publike të Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse dhe njësitë administrative.
- Përgatit dhe ndjek dokumentacionin teknik të projekteve të investimeve që financohen nga fondet e bashkisë ose nga burime të tjera financimi.
- Asiston në përgatitjen e preventivave, përlllogaritjeve të punimeve, specifikimeve teknike dhe grafikëve të zbatimit për çdo projekt investimi.
- Ndjek në terren zbatimin e projekteve, monitoron ecurinë e punimeve dhe raporton periodikisht për përparimin e tyre.
- Siguron që punimet të kryhen në përputhje me projektet e miratuara, me standardet e cilësisë dhe me legjislacionin teknik në fuqi.
- Mban kontakt të vazhdueshëm me mbikëqyrësit e punimeve, zbatuesit, kontraktorët dhe institucionet mbështetëse për të siguruar realizimin korrekt të investimeve.
- Përgatit raporte mujore për gjendjen e zbatimit të projekteve, problemet e konstatuara dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre.
- Verifikon përputhshmërinë ndërmjet punimeve të kryera dhe faturave përkatëse përpara procedurës së likuidimit.
- Asiston në procesin e kolaudimit dhe dorëzimit të objekteve të përfunduara në përdorim.
- Përditëson bazën e të dhënave për të gjitha projektet e investimeve që janë në proces ose të përfunduara.
- Bashkëpunon me specialistët e mirëmbajtjes për evidentimin e nevojave për ndërhyrje apo rehabilitime në objektet publike.
- Kujdeset për arkivimin korrekt të dokumentacionit teknik, kontratave dhe akteve të zbatimit të investimeve.
- Zbaton çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga drejtuesi i sektorit apo drejtoria, që lidhet me fushën e investimeve publike.
- Te ndjeke te gjitha veprimet administrative ndermjet Bashkise Roskovec dhe OSHEE ne fushen e energjise, si dhe person pergjegjes per ndjekjen e cdo kontrate te lidhur ndermjet Bashkise Roskovec dhe OSHEE.
- Kontrollon zbatimin e drejtperdrejte te procedurave dhe standarteve te percaktuara me ligj qe kane te bejne me monitorimin e kontratave te energjise per objektet dhe ndricimin e rrugeve, trotuareve , lulishteve a shesheve nen juridiksion te Bashkise Roskovec.
- Organizon punen sipas kerkesave qe ka Sektori, institucioneve te tjera te Bashkise apo varesise, per te gjitha problematikat e ndryshme ne lidhje me ndricimin. - Zgjidh problemet e perditshme ne lidhje me nevojat per instalime , riparime , nderhyrje apo monitorime te sistemeve te ndricimit ne ndertesat , rruget , sheshet , lulishtet ne varesi te Bashkise.
- Planifikon nevojat e bashkise ne lidhje me shtimin e siperfaqeve me ndricim rrugor dhe merr pjese ne hartimet e PBA ne programet e ndricimit. - Mban kontakte te drejtperdrejta me OSSHE-ne dhe merr masa per monitorimin dhe raportimin e harxhimit te energjise ne objektet , ndricimin rrugor...
- Planifikon masat per sigurimin teknik dhe instruktimin e punonjesve me rregulloren e sigurimit teknik.

- Harton preventivat per riparimet apo instalimet e mundshme dhe nenshkruan siguracionet e tyre.
- Ndjek problematikat dhe koordinon me Drejtorite, sektoret apo per nevojat per nderhyrje.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e lëvizjes paralele janë:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori,
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Te zoteroje nje Diplomë “Bachelor” në Arkitekturë/Inxhinieri Elektrike/Ndertimi apo fusha të ngjashme me to.. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- b) Të kenë eksperiencë pune mbi 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dërgojë dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të një vleresimi vjetor.
- Fotokopje të aktit të konfirmimit të Satatusit të nëpunësit civil.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.

- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- Vërtetim gjendjes shëndetsore;

Dokumentet duhet të dorëzohen në institucion, brenda datës 10.04.2026.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12.04.2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit në Bashkisë Roskovec do të shpallë në portalin “Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së tyre.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjes vendore”
- b. Njohuritë mbi Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c. Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe VKM në zbatim të tij.
- d. Njohuritë mbi ligjin nr.136/2015 datë 5.12.2015 “Kodi i Punës Republikës së Shqipërisë”
- e. Njohuritë mbi ligjin nr. 8485 dt. 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative”
- f. Njohuritë mbi ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- g. Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
- h. VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar;
- i. VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” i ndryshuar;

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohet me 60 pikë.

Totali i pikëve është 100 pikë.

1.6

DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Për datën dhe vendin e konkurimit kandidatët do të njoftohen nga Drejtoria e Burimeve Njerezore, Juridike dhe Arkivit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Roskovec do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë Roskovec dhe në portalin “Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimi në Shërbimin Civil

Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ky pozicion do të jetë i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë personat që janë jashtë shërbimit civil.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil:

- a. Te jete shtetas shqiptar;
- b. Te kete zotesi te plote per te vepruar;
- c. Te zoteroje gjuhen shqipe, te shkruar dhe te folur;
- d. Te jete ne kushte shendetesore qe e lejojne te kryeje detyren perkatese;
- e. Te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje kundervajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij te mos jete marre masa disiplinore e largimit nga sherbimi civil, qe nuk eshte shuar sipas ligjit nr. 152/2013.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) te zoteroje nje Diplomë “Bachelor” në Arkitekturë/Inxhinieri Elektrike/Ndertimi apo fusha të ngjashme me to. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

d) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.

Dokumentet duhet të dorëzohen në institucionin e Bashkisë Roskovec, brenda datës 15.04.2026

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **25.04.2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec do të shpallë në portalin “Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit individua, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e depozitimit të ankesës.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë mbi Ligjin Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjes vendore”
- b. Njohuritë mbi Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- c. Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe VKM në zbatim të tij.
- d. Njohuritë mbi ligjin nr.136/2015 datë 5.12.2015 “Kodi i Punës Republikës së Shqipërisë”
- e. Njohuritë mbi ligjin nr. 8485 dt. 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative”
- f. Njohuritë mbi ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- g. Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
- h. VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar;

- i. VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” i ndryshuar;

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Roskovec.

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pike të cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

2.6 DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njërëzore, Juridike dhe Arkivit e Bashkisë Roskovec do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Drejtoria e Burimeve Njërëzore, Juridike dhe Arkivit do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Roskovec, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Roskovec duke filluar nga data: 25/04/2026

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE JURIDIKE DHE ARKIVIT

BASHKIA ROSKOVEC